



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 43 datë 23.09.2015

Për

**“DHËNIEN E TITULLIT “MIRËNJOHJE E QYTETIT TË TIRANËS”
ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TË
NDËRMARRJEVE DHE TË FONDACIONIT SHQIPTARO-AMERIKAN PËR
ZHVILLIM”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenin 8/VII, gërma “a” dhe nenit 32, gërma “m” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); në vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës, Nr.137, dt 30.07.1999 “Për miratimin e titujve vlerësues të Bashkisë së Tiranës”, Këshilli Bashkiak i Tiranës;

V E N D O S I:

1. Të miratojë propozimin për dhënie e titullit “Mirënjohje e qytetit të Tiranës” anëtarëve të bordit të Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve dhe të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim. Përkatësisht:

- | | |
|--------------------------|------------------|
| • Michael Granoff, | Kryetar i Bordit |
| • Domenick G. Scaglione, | Kryetar Nderi |
| • Dianne Blane | Anëtar |
| • Cafo Boga | Anëtar |
| • Douglas G. Carlston | Anëtar |
| • James H. Duffy | Anëtar |
| • Ylli Çabiri | Anëtar |
| • Jill Adler | Anëtar |
| • Ron Cami | Anëtar |

Me motivacionin:

“Për kontributin shumë të çmuar mbi 20 vjeçar në vendin tonë dhe në qytetin e Tiranës, për transformimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve të Tiranës, duke mbështetur sipërmarrjen dhe biznesin e qytetit, si dhe angazhimin në mbrojtjen e vlerave të historisë së pasur të Tiranës dhe të trashëgimisë së saj kulturore”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Promovimit të Qytetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ALDRIN DALIPI

